



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të dispozitave të nenit 44.2 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2006, merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT, TË DT: 04.11.2004, LIDHUR ME
VAZHDIMIN E SHFRYTËZIMIT TË KATIT TË EPËRM TË
NDËRTESES NGA FILHARMONIA E KOSOVËS

I

Ndryshohet Vendimi, i dt:04.11.2004, për shfrytëzimin e katit të epërm të ndërtesës nga Filharmonia e Kosovës.

II

Filharmonisë së Kosovës i lejohet vazhdimi i shfrytëzimit të përkohshëm të katit të epërm të ndërtesës edhe për një vit.

III

Përmbartimin e këtij Vendimi dhe mbikëqyrjen e shfrytëzimit të këtij objekti e bën Bordi i drejtorëve, Drejtorati i Kulturës dhe i Gjinisë dhe Drejtorati i Financave dhe i Pronës.

IV

Kushtet e dhënies do të përcaktohen me kontratë të veçantë, të lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Filharmonisë së Kosovës.

V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.361-88, më 21.02.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri